



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE**

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____.____.2026

PËR

**DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.797, DATË 29.9.2010, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE PËR MIRATIMIN RREGULLORES HIGJENO-
SANITARE “MBI ADMINISTRIMIN E CILËSISË SË UJËRAVE TË LARJES”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, nenit 8 të ligjit nr.7643, datë 02.12.1992, “Për Shëndetin Publik dhe Inspektoratin Sanitar Shtetëror”, i ndryshuar, dhe pikës 4 të nenit 42, të ligjit nr.10138, datë 11.05.2009, “Për shëndetin publik”, i ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

Në vendimin nr.797, datë 29.9.2010 të Këshillit të Ministrave për miratimin e rregullores higjeno-sanitare “Mbi administrimin e cilësisë së ujërave të larjes”, si dhe në rregulloren bashkëlidhur vendimit, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në të gjithë përmbajtjen e vendimit dhe të rregullores që i bashkëlidhet:
 - a) togfjalëshi “Ministria e Shëndetësisë” dhe akronimi “MSH”, zëvendësohet me togfjalëshin “ministria përgjegjëse për shëndetësinë”;
 - b) togfjalëshi “Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe akronimi “MMMPAU”, zëvendësohet sipas rastit me togfjalëshat “ministria përgjegjëse për mjedisin” ose “ministria përgjegjëse për turizmin”;
 - c) togfjalëshi “Ministria e Punëve Publike dhe Transportit” dhe akronimi “MPPT” zëvendësohet me togfjalëshin “ministria përgjegjëse për punët publike”;
 - d) togfjalëshi “Inspektorati Sanitar Shtetëror” dhe akronimi “ISSH”, zëvendësohet me emërtimin e autoritetit përgjegjës në varësi të parashikimit në këtë rregullore;
 - e) togfjalëshi “Inspektorati i Mjedisit” dhe akronimi “IM”, zëvendësohet me togfjalëshin “inspektorati në fushën e mjedisit”;
 - f) togfjalëshi “pushteti vendor” zëvendësohet me togfjalëshin “njësitë e vetëqeverisjes vendore”;
 - g) Termi “afat-shkurtër”, shkruhet “afatshkurtër”.
2. Neni 1 riformulohet si më poshtë:

“Objekti dhe qëllimi

1. Kjo rregullore përcakton rregulla për:
 - a) monitorimin dhe klasifikimin e cilësisë së ujërave të larjes;
 - b) menaxhimin e cilësisë së ujërave të larjes; dhe
 - c) dhënien e informacionit për publikun mbi cilësinë e ujërave të larjes.
2. Qëllimi i kësaj rregulloreje është ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së mjedisit dhe mbrojtja e shëndetit publik në zbatim të ligjit nr.29/2024, “Për burimet ujore”.
3. Në pikën 1 të nenit 2, termi “aplikohet” zëvendësohet me termin “zbatohet”, ndërsa shkronjat b) dhe c) të pikës 2 riformulohen si më poshtë:

“b) ujërat e kufizuara që i nënshtrohen trajtimit ose përdoren për qëllime terapeutike” dhe

c) “ujërat artificialisht të kufizuara dhe të ndara nga ujërat sipërfaqësore dhe ujërat nëntokësore.”
4. Në nenin 3 të rregullores bëhen këto ndryshime:
 - a. Pikat 2, 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8 shfuqizohen.
 - b. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Termat “ujëra sipërfaqësore”, “ujëra nëntokësore”, “ujëra të brendshme”, “ujëra tranzitore”, “ujëra bregdetare”, “basen lumor” dhe “person i interesuar”, mbartin të njëjtin kuptim si në ligjin nr. 29/2024 “Për burimet ujore”.
 - c. Pika 9 riformulohet si vijon:

“9. Autoritet kompetent: autoriteti ose autoritetet e përmendura në nenin 4 të kësaj rregulloreje, ose çdo autoritet apo organ tjetër, të cilit i janë deleguar, në përputhje me legjislacionin në fuqi, funksionet për sigurimin e pajtueshmërisë me kërkesat e kësaj rregulloreje.”
 - d. Në pikën 13 termi “administruese” zëvendësohet me termin “menaxhuese”; në gërmën a) togfjalëshi “krijimi dhe ruajtja” zëvendësohet me togfjalëshin “përcaktimi dhe mirëmbajtja” dhe në gërmën b), dhe termi “krijimi” zëvendësohet me termin “hartimi”.
 - e. Në pikën 19 termi “ISSh” zëvendësohet me togfjalëshin “institucioni monitorues në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit”.
 - f. Pas pikës 22 shtohet pika 23 me këtë përmbajtje: “Institucion monitorues: institucioni përgjegjës për kryerjen e monitorimit të cilësisë së ujërave të larjes, të përcaktuar në përputhje me legjislacionin në fuqi për monitorimin e mjedisit.”
5. Neni 4 riemërtohet “Përgjegjësitë e autoriteteve kompetente për administrimin e ujërave të larjes” dhe bëhen këto ndryshime:
 - a. pika 1 shkruhet: “Përgjegjësitë e autoriteteve kompetente për administrimin e ujërave të larjes janë:”.
 - b. Shkronjat a) dhe b) të pikës 1 shfuqizohen.
 - c. Pas shkronjës b) shtohet shkronja b/1 me këtë përmbajtje:

“b/1) monitorimi i cilësisë së ujërave të larjes;”

- d. Pika 2 e nenit 4 riformulohet si më poshtë:
- “2. Kompetencat sipas pikës 1, ushtrohen:
- i. për shkronjat b/1), c), f) dhe g), nga ministria përgjegjëse për mjedisin dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit.
 - ii. për shkronjat d) dhe i), nga autoriteti ose autoritetet kompetente të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi;
 - iii. për shkronjën e), nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore,
 - iv. për shkronjën h), nga njësitë e vetëqeverisjes vendore në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për turizmin,
 - v. për shkronjat j), k), l), m), nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.
 - vi. për shkronjat n), o) dhe p), nga njësitë e vetëqeverisjes vendore në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për çështjet e turizmit.
 - vii. Paragrafi i fundit i pikës 2, të nenit 4 shfuqizohet.
6. Në nenin 5 bëhen këto ndryshime:
- a. Pika 1 riformulohet: “Për secilin prej ujërave të larjes duhet të kryhet monitorimi sipas kalendarit të monitorimit i cili duhet të zhvillohet gjatë periudhës së sezonit të larjes.”
 - b. Pika 2 riformulohet: “Monitorimi i cilësisë së ujërave të larjes kryhet nga institucioni monitorues sipas legjislacionit në fuqi.
 - c. Fjala e parë e pikës 4 riformulohet: “Për secilin ujë të larjes, monitorohen parametrat e përcaktuar në shtojcën I, në përputhje me shtojcën IV.”
 - d. Në pikën 6, referimi në paragrafin 4 bëhet në paragrafin 1.
 - e. Pika 7 riformulohet si më poshtë vijon:
- “7. Institucioni monitorues informon Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për çdo pezullim të kalendarit të monitorimit. Agjencia Kombëtare e Mjedisit njofton ministrinë përgjegjëse për mjedisin e cila raporton pranë Komisionit Evropian çdo pezullim të kalendarit të monitorimit, duke dhënë arsyet e pezullimit. Një raport i tillë duhet të dërgohet, më së voni, në rastin e raportit vjetor të radhës të parashikuar në nenin 13.”
- f. Pas pikës 7 shtohet pika 7/1 me këtë përmbajtje:
- “Kur gjatë monitorimit konstatohen rezultate që tregojnë ndotje ose rrezik për shëndetin e personave që lahen, institucioni monitorues njofton menjëherë ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe njësinë e vetëqeverisjes vendore përkatëse për marrjen e masave menaxhuese sipas parashikimeve të pikës 13 të nenit 3 të kësaj rregulloreje.”
- g. Në pikën 8, hiqet togfjalëshi “ISSH-ja siguron që” dhe emërtimi “ministra përgjegjëse për shëndetësinë”, zëvendësohet me emërtimin “Instituti i Shëndetit Publik”.
 - h. Pika 9 shfuqizohet.
7. Në nenin 6 bëhen këto ndryshime:

- a) Në pikën 1, hiqet togfjalëshi “ISSH-ja siguron që”
 - b) Pika 2 riformulohet: “Vlerësimi vjetor i cilësisë së ujërave të larjes kryhet: ”
 - c) Në pikën 3, akronimi “MSH-ja” zëvendësohet me “Ministria përgjegjëse për mjedisin” dhe pas fjalisë së parë shtohen fjalitë: “Në këtë rast, duhet të njoftojë paraprakisht Komisionin. Gjithashtu, duhet të njoftojë Komisionin Evropian nëse më pas vendos të rikthehet në kryerjen e vlerësimeve në bazë të katër sezoneve të larjes.”
 - d) Në pikën 6 të nenit 6, akronimi “ISSH-ja” zëvendësohet me togfjalëshin “Agjencia Kombëtare e Mjedisit në bashkëpunim me Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore”. Në shkronjën a), termi “përputhen” zëvendësohet me togfjalëshin “janë ngjitur me njëri-tjetrin”, në shkronjën c) termi “rrezikshmëri” zëvendësohet me termin “rrezik” dhe hiqet termi “të njëjtë”.
8. Në nenin 7 bëhen këto ndryshime:
- a. Në pikën 1, akronimi “ISSH-ja” zëvendësohet me “ministria përgjegjëse për mjedisin”.
 - b. Në pikën 2, viti “2012” zëvendësohet me vitin “2027”.
 - c. Në fjalinë e parë të pikës 3, togfjalëshi “Pushteti vendor, MMPAU-ja dhe MPT-ja duhet të sigurojnë që,” hiqet.
 - d. Në fjalinë e dytë të pikës 3, togfjalëshi “Ata duhet të ndërmarrin”, zëvendësohet me togfjalëshin “Gjithashtu, duhet të ndërmerren”.
 - e. “Pushteti vendor, MMPAU-ja dhe MPT-ja duhet të sigurojnë që,” hiqen dhe viti “2015”, zëvendësohet me vitin “2030”.
 - f. Në vijim të fjalisë së parë të pikës 4, shtohen togfjalëshi “dhe të jenë në pajtim me këtë rregullore nëse”, ndërsa në fjalinë e dytë hiqet togfjalëshi “Në këtë rast, autoriteti kompetent siguron që”.
 - g. Në shkronjën b), akronimi “ISSH-ja” zëvendësohet me togfjalëshin “struktura inspektuese përgjegjëse”
 - h. Pika 5 shfuqizohet.
9. Në nenin 8 bëhen këto ndryshime:
- a) Në pikën 1, akronimi “ISSH-ja” zëvendësohet me togfjalëshin “Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore” dhe togfjalëshi “Çdo profil mund të mbulojë” zëvendësohet me togfjalëshin “Një profil mund të përfshijë”;
 - b) Në pikën 3, fjalët “direktivës 76/160/KEE” zëvendësohet me fjalët “ligjit 29/2024 “Për burimet ujore”, që janë relevante për këtë rregullore.”
10. Në nenin 9, togfjalëshi “ISSH-ja i rekomandon pushtetit vendor” zëvendësohet me togfjalëshin “Njësitë e vetëqeverisjes vendore në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe autoritetet shëndetësore përgjegjëse, marrin” dhe termi “arsyetohet “ zëvendësohet me termin “vlerësohet”.
11. Në nenin 10 bëhen këto ndryshime:

- a. Në pikën 1, akronimi “ISSH-ja” zëvendësohet me togfjalëshin “Agjencia Kombëtare e Mjedisit” dhe termi “ndërmerr”, zëvendësohet me termin “organizon”.
 - b. Në pikën 2, togfjalëshi “autoritetet kompetente” zëvendësohet me togfjalëshin “njësitë e vetëqeverisjes vendore” dhe termi “administruese” zëvendësohet me termin “menaxhuese”.
 - c. Pika 3 e nenit 10 shfuqizohet
12. Në nenin 11 bëhen këto ndryshime:
- a. Në pikën 1, “Inspektorati Sanitar Shtetëror”, zëvendësohet me togfjalëshin “struktura inspektuese përgjegjëse”, termi “observime”, zëvendësohet me termin “vëzhgime” dhe togfjalëshi “Autoritetet kompetente” zëvendësohet me “njësitë e vetëqeverisjes vendore”.
 - b. Fjalja e parë e pikës 2 bëhet “Ujërat e larjes kontrollohen vizualisht për të dalluar ndotje si mbetje bituminoze, materiale xhami, plastike, gome dhe mbetje të tjera.” Në fjalinë e dytë, togfjalëshi “Autoritetet kompetente” zëvendësohet me togfjalëshin “njësitë e vetëqeverisjes vendore”.
 - c. Pika 3 e nenit 11 shfuqizohet
13. Në nenin 12, togfjalëshi “ISSH, IM dhe pushteti vendor të përfshira, bashkëpunojnë në mënyrën më të përshtatshme për implementimin” zëvendësohet me togfjalëshin “duhet të sigurohet bashkëpunimi i duhur me shtetin ose shtetet fqinje, për zbatimin”.
14. Në nenin 13 bëhen këto ndryshime:
- a. Pika 1 bëhet “Njësitë e vetëqeverisjes vendore, inkurajojnë pjesëmarrjen e publikut në zbatimin e kësaj rregulloreje dhe sigurojnë që personave të interesuar u është dhënë mundësia”.
 - b. Në paragrafin e fundit të pikës 1, togfjalësi “sipas nenit 5, pika 1”, bëhet “sipas nenit 4, pika 1, shkronja i” dhe togfjalëshi “Autoritetet kompetente”, zëvendësohet me togfjalëshin “Njësitë e vetëqeverisjes vendore”.
 - c. Pikat 2, 3 dhe 4, të nenit 13 shfuqizohen.
15. Në nenin 14 bëhen këto ndryshime:
- a. Në pikën 1 bëhen këto ndryshime:
 - i. togfjalëshi “Autoritetet kompetente, secili sipas kompetencës së vet, sigurojnë që të dhënat e mëposhtme të shpërndahen”, zëvendësohet me togfjalëshin “Njësitë e vetëqeverisjes vendore sigurojnë që informacioni i mëposhtëm të shpërndahet”.
 - ii. Në shkronjën a), togfjalëshi “klasifikimin aktual të ujërave të larjes dhe çdo ndalim të larjes” zëvendësohet me togfjalëshin “klasifikimi aktual i ujërave të larjes dhe çdo ndalim i larjes”.
 - iii. Në shkronjën b), togfjalëshi “një përshkrim të përgjithshëm të ujërave të larjes”, zëvendësohet me togfjalëshin “një përshkrim i përgjithshëm i ujërave të larjes”.
 - iv. Në shkronjën c), iii), termi “paralajmërim”, zëvendësohet me termin “paralajmërimi”.

- v. Në shkronjën d), termi “informacion”, zëvendësohet me termin “informacioni”.
 - vi. Në shkronjën e), togfjalëshi “informohet publiku me të gjitha mjetet e mënyrat e efektshme të komunikimit dhe paraqiten”, zëvendësohet me togfjalëshi “njoftimi që larja është e ndaluar dhe”.
 - vii. Në shkronjën f), togfjalëshi “sa herë që paraqitet një ndalim i përhershëm i larjes, një njoftim” zëvendësohet me togfjalëshi “sa herë që vendoset ndalimi i përhershëm i larjes, njoftimi”.
 - viii. Në shkronjën g), fjalët “një tregues i”, zëvendësohet me fjalët “lista e”.
- b. Në pikën 2 bëhen këto ndryshime
- i. togfjalëshi “Pushteti vendor, sipas sugjerimeve të MSH-ISSH, përdor” zëvendësohet me togfjalëshi “Njësitë e vetëqeverisjes vendore përdorin”.
 - ii. Shkronja a) riformulohet si “a) një listë të ujërave të larjes dhe vendndodhjen e tyre;”
 - iii. Në shkronjën d), termi “të keqe”, zëvendësohet me termin “e keqe”.
 - iv. Në shkronjën e), ii), termi “shkalla”, zëvendësohet me termin “shkallën”.
 - v. Pikat 3 dhe 4 shfuqizohen.
 - vi. Në pikën 5, togfjalëshi “Autoritetet kompetente”, zëvendësohet me togfjalëshi “Njësitë e vetëqeverisjes vendore”.

16. Pas nenit 14, shtohet neni 15 me përmbajtjen si më poshte vijon:

“ Neni 15

Raportimi

Ministria përgjegjëse për mjedisin, nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, përgatit raportin vjetor mbi rezultatet e monitorimit dhe vlerësimin e cilësisë së ujërave të larjes për çdo ujë të larjes, si dhe një përshkrim të masave të rëndësishme të menaxhimit të ndërmarra. Ky informacion i raportohet Komisionit Evropian çdo vit, brenda afatit, në lidhje me sezonin e larjes paraardhës.

- 17. Në dy tabelat e para të shtojcës I hiqen emërtimet “A”, “B”, “C”, “D” dhe “E” të kolonave kalojnë në rresht të parë, ndërsa simbolet “*” dhe “**” zhvendosen në rreshtin e dytë të dy tabelave.
- 18. Tabela “Parametrat fiziko-kimikë” e shtojcës I, hiqet.
- 19. Në shtojcën II, togfjalëshat ““cilësi e dobët””, ““cilësi e mjaftueshme””, ““cilësi e mirë”” dhe ““cilësi e shkëlqyer””, zëvendësohen me togfjalëshat “cilësi “e keqe””, “cilësi “e mjaftueshme””, “cilësi “e mirë”” dhe “cilësi “e shkëlqyer””.
- 20. Në pikën 1 të shtojcës II, togfjalëshi “më të ulta” zëvendësohet me togfjalëshin “më të larta”.
- 21. Në pikën 2 të shtojcës III, fjalia “Në rastin e ujërave të larjes të klasifikuar më parë të “cilësisë e shkëlqyer”, profili i ujërave të larjes duhet të rishikohet dhe të përditësohet nëse është e nevojshme, vetëm nëse klasifikimi ka ndryshuar në cilësi “e mirë”, “e mjaftueshme” ose “e keqe”” riformulohet: “Në rastin e ujërave të larjes të klasifikuar më parë të cilësisë “e shkëlqyer”, profili i ujërave të larjes

duhet të rishikohet dhe të përditësohet nëse është e nevojshme, vetëm nëse klasifikimi ka ndryshuar në cilësi "e mirë", "e mjaftueshme" ose "e keqe".

22. Shtojca V ndryshon si më poshtë vijon:

SHTOJCA V

Metodologjia e marrjes së kampionit dhe analizave mikrobiologjike

1. Pika e marrjes së kampionit
Aty ku është e mundur, kampionet merren 30 centimetra nën sipërfaqen e ujit dhe në ujëra që janë të paktën 1 metër të thellë.
2. Sterilizimi i shisheve të kampioneve:
Shishet e kampioneve i nënshtrohen:
 - sterilizimit në autoklavë për të paktën 15 minuta në 121°C, ose
 - sterilizimit të thatë për të paktën një orë, në një temperaturë ndërmjet 160°C dhe 170°C, ose
 - janë shishe të rrezatuara të furnizuara drejtëpërdrejtë nga prodhuesi.
3. Marrja e kampionit:
 - a) Vëllimi i shishes/kontenierit për marrjen e kampionit varet nga sasia e ujit, e nevojshme për të analizuar secilin parameter. Në përgjithësi, vëllimi minimal është 250 ml.
 - b) Shishet/kontenierët e marrjes së kampioneve duhet të jenë te tejdukshëm dhe pa ngjyrë (qelq, polietilen ose polipropilen).
 - c) Me qëllim parandalimin e ndonjë ndotjeje aksidentale të kampionit, personi që e merr kampionin përdor teknika aseptike për të ruajtur sterilitetin e shisheve/kontenierëve të kampioneve. Në rast se marrja e kampionit realizohet sipas procedurës së duhur, nuk është nevoja për pajisje sterile të tjera (si doreza sterile kirurgjikale, pinceta apo tuba).
 - d) Kampioni duhet të identifikohet qartësisht me bojë që nuk del në shishe/konteiner dhe në formularin shoqërues të saj.
4. Ruajtja dhe transportimi i kampioneve para analizës
 - a) Gjatë të gjitha fazave të transportit, kampionet e ujit duhet të mbrohen nga ekspozimi ndaj dritës, veçanërisht ndaj dritës së drejtëpërdrejtë të diellit.
 - b) Kampionet duhet të ruhen në një temperaturë rreth 4°C, në një kuti termale ose frigorifer (në varësi të motit) deri në mbërritjen në laborator. Në rast se transporti deri në laborator ka të ngjarë të zgjasë më shumë se 4 orë, atëherë është i detyrueshëm transporti i kampionit në një frigorifer.
 - c) Koha ndërmjet marrjes së kampioneve dhe analizës së tyre duhet të jetë sa më shkurtër që të jetë e mundur. Rekomandohet që kampionet të analizohen në të njëjtën ditë pune në të cilën janë marrë kampionet. Nëse për arsye praktike, një gjë e tillë është e pamundur, atëherë kampionet përpunohen brenda jo më shumë se 24 orëve. Ndërkohë, kampionet ruhen në një vend të errët në një temperaturë prej 4°C ±3°C.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA